

STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"QUALITY SMILE" SH.P.K

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, më 20 tetor 2021, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin QUALITY SMILE SH.P.K.

(2) Themeluesit e shoqërisë janë:


- **Angelo Russo**, i biri i Giovanni, i datëlindjes 14 nëntor 1963, lindur në Teverola, Caserta, Itali, shtetas italian, banues në adresën DR Tirana Jug, Rruga Ndre Mjeda, Nr.ap;8, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. YB7475354 lëshuar më 15 shtator 2020 nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë (Ministro Affari Esteri e Cooperazione Internazionale), me kod fiskal RSNGL63S14L155Q.

- **Edmond Kristo**, i biri i Thomait, i datëlindjes 02 korrik 1963, lindur dhe banues në Elbasan, shtetas shqiptar, banues në adresën lagja "Beqir Dardha", rruga "Reshit Çelirama", Nr.1, Elbasan, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ID me nr. 034275896, me nr. personal G30702154U, lëshuar më 27 maj 2019 nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Shqipërisë

- **Marsida Suvarija**, e bija e Sinanit, e datëlindjes 25 gusht 1984, lindur dhe banuese në Tiranë, shtetase shqiptare, banuese në adresën "Artan Lenja"; Nd. Dorado; H. 1; Ap. 1207, Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023, Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e pasaportës me nr. BB8006745, me nr. personal I45825058R, lëshuar më 01 shkurt 2019 nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Shqipërisë

- **Erion Suvarija**, i biri i Eduartit, i datëlindjes 15 gusht 1982, lindur dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën "Artan Lenja"; Nd. Dorado; H. 1; Ap. 1207, Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ID me nr. 035719962, me nr. personal I20815067A, lëshuar më 28 janar 2020 nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Shqipërisë

- **Sokol Qoli**, i biri i Aqifit, i datëlindjes 14 gusht 1985, lindur dhe banues në Elbasan, shtetas shqiptar, banues në adresën lagja "Aqif Pasha", rruga "Ymer Myzyri", Elbasan, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. BD0874230, me nr. personal I508140706,



lëshuar më 16 korrik 2015 nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Shqipërisë

**Neni 2:
Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
Import dhe eksport për përmbushjen e objektit dhe qëllimeve të saj, shërbim konsulence për kurat dentare, shërbim konsulence për kurat në fushën e mjekësisë estetike, kirurgjisë plastike invazive dhe joinvazive. Shërbime konsulence në fushën e estetikës, dietologjisë, mirëqenies fizike. Konsulencë në fushën e turizmit dhe hotelerisë apo në fusha të ngjashme si turizëm shëndetësor, turizëm dentar, turizëm i mjekësisë dhe kirurgjisë estetike, turizëm wellness. Call center, agjent shitjesh online, shërbim klienti online. Shërbime konsulence në fushën e rezervimeve, prenotimeve, akomodimeve etj.

Tregtimin, importin, eksportin, shit-blerjen e implanteve dentare dhe materialeve të tjera të përdorshme në fushën dentare. Distribucion ekskluziv produktesh të higjienës orale dhe të kujdesit personal. Shoqëria mund të kryejë çdo lloj aktiviteti tjetër apo operacioni tregtar që lejon ligji shqiptar për përmbushjen e qëllimeve të saj; mund të hyjë në tratativa biznesi apo bashkëpunimi me shoqëri, organizata, ente private dhe publike që kanë objekt aktiviteti të ngjashëm ose jo. Tregtimi, importi, shit-blerja e materialeve dhe pajisjeve mjekësore.

**Neni 3:
Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të filojë me regjistrimin e saj juridik dhe fiskal në Regjistrin Tregtar dhe do të vazhdojë për një periudhë kohore të pakufizuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo moment, sipas vendimeve të marra nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë.

**Neni 4:
Selia**


(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Lagja Skënderbej, zona kadastrale nr.8523, pasuria nr.17/347, ish Magazinat e Grumbullimit

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:
thequalitysmile@gmail.com

**Kreu II
Kapitali**

**Neni 5
Kapitali themeltar**

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100'000 (njëqind mijë) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:



2



1. Ortaku themelues **Angelo Russo**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 34'000 lekë (tridhjetë e katër mijë) që përbën 34% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues **Edmond Kristo**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 51'000 lekë (pesëdhjetë e një mijë) që përbën 51% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. Ortaku themelues **Marsida Suvarija**: Zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 5'000 lekë (pesë mijë) që përbën 5% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
4. Ortaku themelues **Erion Suvarija**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 5'000 lekë (pesë mijë) që përbën 5% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
5. Ortaku themelues **Sokol Qoli**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 5'000 lekë (pesë mijë) që përbën 5% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.



Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.


Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.



Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 përqind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12

Përrjashtimi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.



Neni 13

Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personi i mëposhtëm caktohet si administrator i parë i shoqërisë:

- **Edmond Kristo**, i biri i Thomait, i datëlindjes 02 korrik 1963, lindur dhe banues në Elbasan, shtetas shqiptar, banues në adresën lagja "Beqir Dardha", rruga "Reshit Çelirama", Nr.1, Elbasan, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ID me nr. 034275896, me nr. personal G30702154U, lëshuar më 27 maj 2019 nga Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë

Specimeni e nënshkrimit:



Neni 14

Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblesën e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.



-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtari tregtare, kur, në bazë



të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV

Viti financiar-ekspertët

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përgjithësisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e së drejtës vendimore që ka.

Kreu V

Prishja -riorganizimi i shoqërisë


Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në ëdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe



emërtesën shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pague, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKET

E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

* QUALITY SMILE*

- Angelo Russo

Angelo Russo

- Edmond Kristo

Edmond Kristo

- Marsida Suvarija

Marsida Suvarija

NANDOR ÇARKU



- Erion Suvarija

ERION SUVARIJA

- Sokol Qefi

Sokol Qefi